



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

---

**Datë: 04.08.2025**

**Numër Protokolli: 5330/2025**

**A.nr.1149/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1149/2025, të datës 16.06.2025, të parashtruar nga ankuesja Hana Kërlesha, kundër organit të punësimit/Ministria e kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me shumicë votash me datë 04.08.2025 mori këtë;

**V E N D I M**

**Hidhet poshtë** si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1149/2025, e datës 16.06.2025 e parashtruar nga ankuesja, H.K.

**A r s y e t i m**

Ankuesja, H.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 16.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4042/2025 të regjistruar nën shenjen A.nr.1149/2025, me pretendimin ankimor për rritje të koeficientit nga Profesional 3 në profesional 2.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datë 01.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ndërsa kjo e fundit, më datë 09.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me nr.prot 4042/2025 të datës 16.06.2025; E-mali i datës 06.05.2025; Lista e pagave për muajin tetor 2024; Kopja e lehtënjofitimit; Vendimi me Nr.30/2021 i datës 12.11.2021 për deklarimin e statusit të nëpunësve civil; Ankesë për vlerësimin e koeficienteve e datës 27.03.2023 ; Ankesë e datës 17.07.2023 për

anëtarët e komisionit për vlerësimin e koeficienteve/MKRS; E-mail i datës 04.09.a; E-mail i datës 19.09.2023; E-mail i datës 29.11.2024; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 09.07.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 04.09/2017 ; Përshkrimi i detyrave të punës e datës 01.08.2017; Listat e pagave për vitin 2023, 2024 dhe deri muajin korrik 2025 dhe E-mali i datës 04.07.2025.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesja, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, ankuesja është e punësuar në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë/ Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me numër protokolli Nr.377/2017 të datës 06.09.2017, mbanë pozitën e punës *Asistente Administrative* në QRTK-Gjakovë.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka diskriminim në propozimet për klasifikimin e vendeve të punës, sepse disa kolege janë propozuar për klasifikim në profesional 2 ndërsa pozita që mbaj unë në profesional 3.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës të bashkëngjitura nga MKRS, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit në këtë rast Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesja, është e parakohshme, dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës së theksuar më lart, ankueses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së saj të punës.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1149/2025**

**Sabile Avdyli**

**Procesmbajtëse**

**Eshref Shabani**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses, H.K;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MKRS; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.